L I G J
Nr.9433, datë 20.10.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR HUANË DHËNË SHOQËRISË "TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP)" SHPK NGA BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN "PUNËT E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE NDËRTIMI I SEKSIONIT RRUGOR TË AEROPORTIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për huanë dhënë shoqërisë "Tirana Airport Partners (TAP)" shpk nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin "Punët e infrastrukturës publike dhe ndërtimi i seksionit rrugor të aeroportit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4690, datë 8.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJE GARANCIE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE SEKSIONIT RRUGOR TË AEROPORTIT "NËNË TEREZA"

Marrëveshje e datës 23 mars 2005 ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Garantuesi") dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka")

Hyrje

Meqenëse në bazë të Marrëveshjes së huasë të datës 23 mars 2005 ndërmjet Tirana Airport Partners sh.p.k. si Huamarrës dhe Bankës (Marrëveshja e huasë sipas parashikimit të termave dhe kushteve standarde), Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 9 000 000 euro, në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara në marrëveshjen e huasë dhe pagimin e një takse të Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore (një kusht i tillë parashikohet në marrëveshjen e koncesionit) nga Huamarrësi te Garantuesi, por me kusht që Garantuesi të garantojë përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë, në përputhje dhe me këtë Marrëveshje;

meqenëse Garantuesi dhe Huamarrësi kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e pjesës së projektit në përputhje me sesionin 2.03 të Marrëveshjes së huasë;
meqenëse Garantuesi, duke vlerësuar lidhjen e Marrëveshjes së huasë nga Banka me

Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë përmbushjen e detyrimeve të tilla për Huamarrësin;

për sa më sipër, palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Termat dhe kushtet standarde, përkufizimet

Seksioni 1.01 Fusha e zbatimit të termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të shkurtit 1999 kanë efekt dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të gjithë fuqinë dhe efektin e tyre, njëlloj si të ishin parashikuar në këtë Marrëveshje, por me ndryshimet që vijojnë (dispozita të tilla të ndryshuara janë quajtur në vijim "Termat dhe kushtet standarde");

a) Seksioni 4.03 ("Prokurimi") i termave dhe kushteve standarde të Bankës të shkurtit 1999 nuk është i zbatueshëm për këtë Marrëveshje.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Kudo që të jetë përdorur në këtë Marrëveshje (përfshirë pjesën e hyrjes), përderisa nuk është thënë ndryshe ose konteksti të ketë kërkesa të tjera, kushtet e parashikuara në hyrje kanë kuptimin që u jepet në këtë Marrëveshje, kushtet e parashikuara në emrat dhe kushtet standarde dhe në marrëveshjen e huasë kanë kuptimet e dhëna në to dhe përkufizimi "Përfaqësuesi i autorizuar i garantuesit" është Ministri i Financave i Garantuesit.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë marrëveshje, referenca për një nen ose seksion, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të konsiderohet si referencë për këtë nen ose seksion të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancia, detyrime të tjera

Seksioni 2.01 Garancia shtetërore

Garantuesi këtu garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari kryesor dhe jo thjesht si garant, pagimin e përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave sipas Marrëveshjes së huasë, qoftë në momentin e maturimit, me parapagim ose ndryshe, si edhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, ashtu siç janë parashtruar në Marrëveshjen e huasë.

Seksioni 2.02 Taksa e Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore

Palët bien dakord që Garantuesi ka të drejtë të kërkojë pagesën e Taksës së Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore nga Huamarrësi në përputhje me klauzolën 20(d) dhe shtojcën 69 të marrëveshjes së koncesionit.

Neni 3

Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftime

Adresat e mëposhtme parashikohen në funksion të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Garantuesin: Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.1 Tiranë, Shqipëri Në vëmendje të: Drejtorit të Drejtorisë së Borxhit Fax: +355 4 228494	Për Bankën: Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim One Exchange Square London EC2A 2 JN, UK To the attention of: Operational Administration Unit Fax: +44 20 7338 6100 Telex: 8812161 Answerback: EBRD L G

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Në funksion të seksionit 9.03 (b) të termave dhe kushteve standarde dhe në përputhje me seksionin 5.02 (b) të Marrëveshjes së huasë, opinioni apo opinionet ligjore në emër të Garantuesit do të jepen nga Ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të sa më sipër, palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruan

këtë Marrëveshje në katër kopje, në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

Republika e Shqipërisë Nga: Arben Malaj Pozicioni: Ministër i Financave	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim Nga: Riccardo Puliti Pozicioni: Drejtor